

## **Trajnim në temë “Komunikimi dhe zgjidhja e konflikteve dhe zhvillimi i qasjes multietnike për marrëdhënie me opinion”**

Më 21 dhe 22 mars të vitit 2009 në Ohër u realizua trajnim në temë “Komunikimi dhe zgjidhja e konflikteve dhe zhvillimi i qasjes multietnike për marrëdhënie me opinion” me gjithsej 20 pjesëmarrës nga Kërçova, Dibra, Qendra Zhupë, Vraneshticë dhe Drugovë. Trajnimin e organizoi Fondacioni Institut Shoqëri e Hapur – Maqedoni në bashkëpunim me zyrat lokale të projektit në Kërçovë dhe Dibër (Qendra për zhvillim të bashkësive në Kërçovë dhe Qendra për zhvillim të qëndrueshëm të bashkësive Dibër, ish qendrat për përkrahje të OJQ-ve).

Në trajnim morën pjesë 12 përfaqësues të organizatave joqeveritare nga Kërçova, Dibra dhe Qendra Zhupë, 2 përfaqësues nga institucionet e Kërçovës dhe Vraneshticës, 4 përfaqësues nga njësitë e vetëqeverisjes lokale nga Kërçova, Vraneshtica dhe Dibra dhe 2 përfaqësues nga këshillat komunale të Kërçovës dhe Drugovës.

Pjesëmarrësit fituan dituri dhe shkathtësi për komunikim jo të dhunshëm, perceptimi si bazë për formimin e sjelljes dhe faktorët që ndikojnë në perceptim, meditacion, qasjet e ndryshme për marrëdhënie me opinion dhe për termin opinion si faktorë plotësues në marrëdhëniet ndëretnike.

Trajnuesit Pavlina Jankulovska dhe Mimoza Bogdanovska – Jovanovska me një qasje interesante krijuan atmosferë të këndshme pune me qëllim të adaptimit më të lehtë të pjesëmarrësve në temë. Nga ana tjetër, pjesëmarrësit morën pjesë aktive në ushtrimet që parashihnin luajtjen e roleve në situata të ndryshme konfliktuoze. Kishte edhe teori ku i dhanë informata të shkurta dhe drejtime që mbahen mend lehtë.

Pjesa më e madhe e pjesëmarrësve ishin mjaft me humor të mirë dhe kreativ gjatë kryerjes së detyrave.